



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 146/8 prot.

Tiranë, më 19.05.2022

VENDIM
Nr. 70, datë 19.05.2022

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 39, DATË 11.3.2022

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 39, datë 11.3.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi *****”, në lidhje me parregullsi në nisjen e procedurës disiplinore ndaj tij”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 146 prot., datë 8.2.2022, nëpunësi *****, i cili kryen detyrën “Drejtor” i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka ngritur pretendimin se, procedura disiplinore ndaj tij është nisur në mënyrë të padrejtë dhe mbi fakte të pavërteta.

Për sa më sipër, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për verifikimin dhe vlerësimin e shkeljes konkrete, si dhe për t’i garantuar të drejtat që ligji për shërbimin civil sanksionon për nëpunësit në një procedurë disiplinore.

Për verifikimin e informacionit, bazuar në nenin 16, kreu III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer hetimi administrativ i këtij rasti. Në funksion të këtij procesi, Komisioneri ka kërkuar nga

institucioni Autoriteti i Konkurrencës të gjithë materialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera për këtë rast. Njëkohësisht për të arritur në konkluzione të sakta, Komisioneri e ka vijuar verifikimin edhe në përmbajtjen e dosjes së personelit dhe të regjistrit të personelit.

Me shkresën nr.110/1, datë 21.2.2022, Autoriteti i Konkurrencës ka vënë në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin që materializon veprimet e kryera deri në marrjen e Vendimit të Komisionit të Disiplinës për nëpunësin *****.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ, procesi është përmbyllur me Vendimin nr.39, datë 11.3.2022, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi *****, në lidhje me parregullsi në nisjen e procedurës disiplinore ndaj tij”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 110/3 prot., datë 5.4.2022, *“Dërgim vendimi mbi ndërprerjen e procedimit disiplinor ndaj *****”*, në lidhje me veprimin administrativ të ndërmarrë në zbatim të detyrës së lënë në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Mbështetur në rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues, si dhe duke verifikuar veprimin administrativ të kryer nga njësia përgjegjëse, i materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i hetimit administrativ paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të vendimit, Komisioneri ka kërkuar nga Komisioni i Disiplinës pranë Autoritetit të Konkurrencës, që të rishqyrtojë çështjen, në lidhje me ecurinë disiplinore të nisur ndaj nëpunësit civil *****, duke bërë një rivlerësim të rrethanave të ngjarjes dhe të veprimeve të kryera nga ky nëpunës, në kushtet kur nuk ka shkaqe të përligjura për vazhdimin e procedimit disiplinor në këtë rast.

Për sa më sipër rezulton se, Komisioni i Disiplinës ka rishqyrtuar çështjen dhe ka arritur në konkluzion se faktet dhe provat e evidentuara gjatë këtij procesi, nuk përbëjnë shkelje të rëndë pasi nuk kanë sjellë pasoja në mospërmbushjen e detyrave nga *****. Me aktin nr. 84/6 prot., datë 23.3.2022, Komisioni i Disiplinës në pikën 1, të vendimit ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor për *****, *“Drejtor”* i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit.

Konstatohet se, nga ana e institucionit, Autoriteti i Konkurrencës, janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 39, datë 11.3.2022, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 39, datë 11.3.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi *****, në lidhje me parregullsi në nisjen e procedurës disiplinore ndaj tij”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Autoriteti i Konkurrencës, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 39, datë 11.3.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha